



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada- Government

2014-2018

**STRATEGJIA KOMBËTARE E REPUBLIKËS SË
KOSOVËS PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E
EKONOMISË JOFORMALE, PASTRIMIN E
PARAVE, FINANCIMIN E TERRORIZMIT DHE
KRIMEVE FINANCIARE 2014-2018**

Janar, 2014, Prishtinë

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME	5
2. HYRJE	10
3. METODOLOGJIA DHE PËRKUFIZIMET	12
3.1. Metodologjia	12
3.1.1. E Përgjithshme	12
3.1.2. Planifikimi strategjik dhe procesi i menaxhimit të rrezikut në Kosovë	13
3.2. Përkufizimet.....	14
4. HISTORIATI DHE ANALIZAT	17
4.1. Angazhimi i Qeverisë për të luftuar kundër ekonomisë joformale, pastrimit të parase, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare	17
4.2. Strategjitë Kombëtare për parandalimin e ekonomisë joformale dhe pastrimit të parase, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2008-2013	17
4.3. Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar për Pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në Kosovë 2013.....	18
4.3.1. Objektiva dhe proceset.....	18
4.3.2. Rreziqet e identifikuara në nivelin nacional në përgjithësi.....	19
4.3.3. Rreziqet që lidhen me ekonominë joformale	19
4.3.4. Rreziqet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet financiare	20
4.4. Informacioni statistikor në lidhje me ekonominë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë	20
4.4.1. Shkalla e ekonomisë joformale	20
4.4.2. Ndikimet e ekonomisë joformale	21
4.4.3. Shkalla e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimet financiare.....	22
4.4.4. Ndikimi i pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare.....	23
4.5. Konkluzionet për shkallën dhe ndikimet e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë	24
4.5.1. Ekonomia joformale.....	24
4.5.2. Pastrimi i Parave, financimi i terrorizmit dhe krimet financiare	25
5. QËLLIMET DHE OBJKATIVAT E STRATEGJISË KOMBËTARE 2014-2018	27
5.1. E përgjithshme	27
5.2. Qëllimet e Strategjisë Kombëtare 2014-2018.....	27
5.3. Objektivat e Strategjisë Kombëtare 2014-2018.....	27
5.4. Përshkrimi i detajuar i objektivave të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Ekonomisë Joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018	28
5.4.1. Ngritja e vetëdijes mbi ndikimet dhe parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimet financiar	28
5.4.2. Forcimi i parandalimit dhe luftës kundër ekonomisë joformale dhe krimet financiar duke rritur transparencën, përgjegjshmërinë, qeverisjen e mirë dhe partneritetin shoqërorë.....	28

5.4.3. Promovimi i zbulimit, hetimit, ndjekjes penale, gjykatave dhe të zbatimit të ndjekjes penale për pastrimin e parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare	28
5.4.4. Forcimi i kapacitetit të institucioneve përkatëse	29
5.4.5. Zhvillimi dhe zbatimi i një qasjeje pro-aktive për bashkëpunim ndërkombëtar për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare	29
5.4.6. Zhvillimi i legjislacionit kombëtarë për tu përshtatur me standardet ndërkombëtare dhe për të siguruar zbatimin e tij efikas	29
6. ALTERNATIVAT E SHQYRTUARA	30
7. REKOMANDIMET	32
8. HARTIMI, RISHIKIMI, MIRATIMI, ZBATIMI DHE MEKANIZMAT MONITORUES TË STRATEGJISË KOMBËTARE	33
8.1. E përgjithshme	33
8.2. Kontribuuesit dhe rolet e tyre.....	33
8.2.1. Qeveria e Republikës së Kosovës	33
8.2.2. Ministria e Financave.....	33
8.2.3. Grupi Punues Qeveritar	33
8.2.4. Sekretariati	34
8.2.5. Grupi Teknik Punues	35
8.2.6. Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike	35
8.2.7. Institucionet e obliguara të sektorit publik, privat dhe të tretë	36
8.3. Hartimi, rishikimi dhe miratimi i strategjisë kombëtare dhe plani i veprimit	36
8.4. Zbatimi dhe monitorimi i strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit	36

LISTA E TABELAVE

1. Ekonomia joformale në Kosovë krahasuar me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor në % të PBB-së
2. Llojet e të hyrave dhe pesha e tyre në buxhetin e Qeverisë së Kosovës 2008-2012
3. Krimet financiare të regjistruara nga Policia e Kosovës, Doganat e Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës 2008-2012
4. Vlera e fondeve të sekuestruara dhe konfiskuara të menaxhuara nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara 2008-2012
5. Vlera e vlerësuar e ekonomisë joformale në Kosovës gjatë 2008-2012

LISTA E SHTOJCAVE

1. Plan i Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018
2. Monitorimi dhe Rishikimi Instrumentit për Strategjinë Shtetërore të Republikës së Kosovës për parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe Krimeve financiare 2014-2018

LISTA E SHKURTESAVE

TFVF	Task Forca për Veprim Financiar
BPV	Bruto Produkti Vendor
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
ISO	Organizata Ndërkombëtare për Standarde
OBZHE	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

1. PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME

Analiza e Historikut

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014 përcakton prioritetet kryesore të nivelit shtetëror. Arritja e këtyrë qëllimeve kërkon që shkalla e ekonomisë joformale duhet të reduktohet dhe vlera e konfiskimit e të ardhurave nga krimi duhet të rritet.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka treguar vullnet për të luftuar kundër ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare. Kjo është bërë duke hartuar dhe zbatuar një sërë ligjesh shtetërore në përputhje me standardet ndërkombëtare si dhe duke krijuar mekanizmin për menaxhim të rrezikut, përfshirë këtu strategjinë e cila përbën udhërrëfyesin për institucionet përkatëse të sektorit publik, privat dhe të tretë.

Ekonomia joformale në shkallë të gjerë dëmton Interesat fiskale të qeverisë duke shkaktuar zvogëlimin e të hyrave. Prandaj, kjo dobëson infrastrukturën shtetërore si dhe aftësinë e shoqërisë për të ofruar shërbime publike. Ndikimet e ekonomisë joformale nuk kufizohen në sektorin publik, por ato afektojnë edhe aktivitetet e biznesit. Ekonomia joformale shtrembëron konkurrencën e ndershme dhe ul konkurrencën midis kompanive. Përdorimi i punës joformale dhe evazioni sistematik i kontributeve të sigurimeve shoqërore dobësojnë mbrojtjen e punonjësve dhe përfitimet e tyre sociale. Një ekonomi e gjerë joformale rrit edhe krimin në shoqëri.

Ekonomia joformale në nivelin global¹ është vlerësuar të jetë e barabartë me 33% të PBB globale. Në BE², madhësia mesatare ishte 18.5% në 2012.

Kalkulimet e fundit makroekonomike sa i përket ekonomisë joformale në Kosovë janë nga viti 2007. Ekipi i një Projekti të BE-së³ ka vlerësuar se shkalla e ekonomisë joformale në Kosovë gjatë 2004-2006 ishte 26.67 – 34.75% të PBB-së së Kosovës. Në vlera absolute është varion mes 605 000 000 EUR dhe 793 000 000 EUR në vit. Megjithatë, e njëjta shkallë e ekonomisë joformale do të thoshte një vlerë absolute mes 1 312 678 800 EUR dhe 1 691 241 600 EUR në vitin 2012⁴. Një studim përfshirë kompanitë është bërë në Kosovë në vitin 2013 për të vlerësuar shkallën e ekonomisë joformale.⁵ Përfundimi i këtij studimi ishte 34.4% e PBB-së.

Shuma totale e të hyrave të përcaktuara në buxhetin e Qeverisë së Republikës së Kosovës është rritur gjatë viteve 2008-2012 nga 0,976 në 1,538 miliardë euro. Të hyrat doganore kanë përfaqësuar 54.9-63.5% të shumës totale dhe të hyrat nga tatimet 17.9-22.7%. Ekonomia joformale ndikon në të hyrat. Kjo kryesisht ka të bëjë me mjetet e mbledhura nga Administrata

¹ Manual në Ekonominë hije, Friedrich Schneider, 2011.

² Platforma Evropiane për të rritur bashkëpunimin evropian në parandalimin dhe ndalimin e punës së padeklaruar, Udhërrëfyesi i Komisionit Evropian, 04/2013.

³ Studimi në Shkallën dhe Parandalimin e Ekonomisë Joformale dhe Pastrimit të Parave në Kosovë, Projekt i BE-së 05KOS01/03/03/001, 2007.

⁴ Bruto Produkti Vendor i Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2013.

⁵ Perspektivë Biznesore e Informalitetit në Kosovë Friedrich Ebert Stiftung dhe Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur dhe Instituti Riinvest për Hulumtime dhe Zhvillim, 2013.

Tatimore. Qeveria e Republikës së Kosovës ka nevojë të rris veçanërisht nivelin e të hyrave nga tatimet.

Shkalla e ekonomisë joformale në Kosovë vlerësohet të jetë në të njëjtin nivel si në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Vlerësimet e fundit në rajon mbulojnë periudhën kohore 2006-2012. Shkalla e ekonomisë joformale në vendet fqinje të Kosovës ndryshon mes 23-38.8% të BPV-së.

Ekipi i Projektit⁶ të financuar nga BE-ja në vitin 2007 ka vlerësuar shkallën e ekonomisë së zezë në Kosovë mes viteve 2004-2006. Vlera minimale, duke përfshirë përfitimet nga krimet e drogës, kundërvajtjet tatimore, kontrabandën dhe prostitucionin, është vlerësuar të jetë mes 301-386 milion euro në vit. Megjithatë, nuk ka llogaritje më të fundit për shkallën e ekonomisë së zezë. Për më tepër, nuk ka statistika të besueshme për numrin vjetor dhe vlerën e vendimeve të përkohshme për sekuestrim dhe gjyqimeve për konfiskim të përfitimeve nga krimi.

Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit në Kosovë 2013 është aprovuar dhe atë si i klasifikuar⁷ nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Rezultatet e vlerësimit treguan se pastrimi i parave, financimi i terrorizmit dhe krimeve të tjera ekonomike dhe financiare, në pjesën më të madhe, konsiderohen të jenë krimet e fshehura. Ky ishte mendimi i përfaqësuesve të sektorit publik, privat dhe të tretë. Ata vlerësuan se korrupsioni, shkeljet tatimore, krimet që lidhen me prokurimin dhe procesin e privatizimit, kontrabanda dhe krime të tjera financiare si dhe krimet e drogës janë veprat më të zakonshme dhe kryesore penale të pastrimit të parave.

Analizat statistikore të kryera gjatë vlerësimit të rrezikut kombëtar 2013 treguan se mashtrimet, falsifikimi i monedhave, kontrabandimi i mallrave dhe uzurpimi i paligjshëm i pasurive të patundshme janë krimet më të zakonshme financiare të njohura gjatë procedurës penale⁸. Nga ana tjetër, u bë e qartë se vlera e përfitimeve të konfiskuara nga krimi ka mbetur në nivel të ulët duke qenë vetëm 29,926 euro në vitin 2012⁹.

Metodologjitë

Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar një mekanizëm të menaxhimit të rrezikut për sa i përket ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare. Ai mekanizëm bazohet në standarde ndërkombëtare^{10,11,12}, dhe përbëhet nga instrumentet e mëposhtme:

⁶ Anketa mbi shkallën dhe Parandalimin e Ekonomisë së paligjshme si dhe pastrimit të parave në Kosovë, projekt i BE-së 05KOS01/03/03/001, 2007

⁷ Vendimi Nr. 06/161, i Qeverisë së Republikës së Kosovës, 18.12.2013.

⁸ Krimet financiare të regjistruara nga Policia e Kosovës, Doganat e Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës 2008-2012, Grupi Punues i Vlerësimit të Rrezikut Shtetëror dhe Projekti i financuar nga BE-ja EuropeAid/132399/C/SER/XK, 2013.

⁹ Statistika 2010-2012, Agjencia për Menaxhimin Pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, 2013

¹⁰ Menaxhimi i rrezikut – Parimet dhe udhëzimet, Standardi Ndërkombëtar ISO 31000, 2009.

¹¹ Menaxhimi i rrezikut – Teknikat e Menaxhimit të rrezikut, Standardi Ndërkombëtar ISO 31010, 2009.

¹² Udhëzimi i TFVF-së për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar për Pastrimin e parave dhe Financimit të terrorizmit

- Vlerësimi i rrezikut kombëtar 2013 për pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018;
- Plani i Veprimit i Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018;
- Buxhetet dhe Planet e performancës të institucioneve relevante publike 2014-2018;
- Platforma e cila siguron partneritetin mes institucionet e sektorit shtetëror publik, privat dhe të tretë sa i përket hartimit, rishikimit, miratimit, zbatimit dhe monitorimit të instrumenteve të menaxhimit të rrezikut.

Procedura e menaxhimit të rrezikut në Kosovë është në përputhje me Udhëzimin¹³ e TFVF-së të Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar për Pastrimin e parave dhe Financimit të terrorizmit si dhe ISO standardet 31000¹⁴ dhe 31010¹⁵. Kjo mbështetet në konsultim dhe komunikim të gjerë me partnerët, përfshirë këtu institucionet më të rëndësishme, ato të sektorit publik, privat dhe të tretë. Rritja e partneritetit mes këtyre palëve të interesit është shumë e rëndësishme dhe një gjë e tillë është siguruar.

Vlerësimi i rrezikut kombëtar 2013 shërben si bazë për objektivat dhe veprimet e Strategjisë Shtetërore dhe Planit të Veprimit 2014-2018. Kjo do të sigurojë menaxhim të qëndrueshëm të rreziqeve.

Analiza dhe Vlerësimi

Vlerësimi i rrezikut kombëtar 2013 gjeneroi një listë prioritare të përbërë nga 35 rreziqe në total. Ato janë klasifikuar në kërcënime dhe cenueshmëri. Rreziqet më të larta që lidhen me ekonominë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare përbëhej nga ngjarjet dhe pasojat si në vijim:

- Efikasiteti i procedurave të planifikimit të performancës të sektorit publik;
- Efikasiteti i mekanizmave të zbulimit dhe parandalimit për korrupsion, krime të tjera financiare dhe të ekonomisë joformale në Kosovë dhe ndikimin e tyre në investimet ndërkombëtare dhe rritjen ekonomike;
- Efikasiteti i zbatimit të kornizës ligjore;
- Mbulimi i legjislacionit sekondar dhe procedurat standarde të veprimit;
- Efikasiteti i gjurmimit të pasurive dhe procedurat e konfiskimit;
- Efikasiteti i zbatimit të vendimeve të konfiskimit, sanksionet administrative dhe procedurat për paaftësinë paguese;
- Kapacitetet dhe aftësitë e gjyqësorit;
- Transparenca dhe llogaridhënia në administratën publike;
- Nepotizmi;
- Shkalla e ekonomisë joformale;
- Ndikimet e ekonomisë së bazuar në para të gatshme;

¹³Po aty.

¹⁴Menaxhimi i Rrezikut – Parimet dhe Udhëzimet, Standardet Ndërkombëtare ISO 31000, 2009.

¹⁵Menaxhimi i Rrezikut – Teknikat e vlerësimit të rrezikut, Standardet Ndërkombëtare ISO 31010, 2009.

- Cenueshmëria e Kosovës ndaj krimeve financiare;
- Cenueshmëria e Kosovës për pastrimin e parave;
- Natyra e veprave penale për pastrim parash;
- Shtrirja e kriminalitetit të fshehur sa i përket pastrimit të parave dhe krimeve të tjera financiare;
- Funkcionalizimi i mekanizmit raportues për transaksione të dyshimta dhe të parave të gatshme;
- Cenueshmëria e sektorëve të caktuar nga ekonomia joformale, pastrimi i parave dhe krimet tjera financiare dhe ekonomike.

Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar 2013 përfshinte masa për trajtimin e rreziqeve të identifikuar. Ato përbëjnë objektivat strategjike të Strategjisë Kombëtare 2014-2018.

Nga Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar 2013 doli një listë me veprime që duhet të kryhen në mënyrë që të zbatohen masat e trajtimit të rreziqeve të identifikuar. Këto aktivitete janë bazë për Planin e Veprimit 2014-2018.

Strategjia kombëtare 2014-2018 dhe qëllimet, objektivat dhe aktivitetet e saj

Qëllimet, objektivat dhe veprimet e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018 janë të bazuara në Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut 2013. Këto dokumente të politikave përbëjnë një mekanizëm të menaxhimit të rrezikut për rreziqet e nivelit kombëtar të ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë. Qëllimi kryesor i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të saj të Veprimit 2014-2018 është të mbështesë arritjen e objektivave të Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014 që janë:

1. Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik;
2. Qeverisje e mirë dhe fuqizim i Sundimit të Ligjit;
3. Zhvillim i kapitalit njerëzor;
4. Mirëqenia sociale.

Arritja e këtyre objektivave të nivelit kombëtar kërkon parandalim efikas të ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare. Strategjia Kombëtare dhe Planin e Veprimit 2014-2018 janë gjithashtu duke mbështetur Kosovën në përmbushjen e angazhimeve në procesin e stabilizimit dhe asociimit të pranimit në BE.¹⁶

Qeveria e Republikës së Kosovës me mbështetjen e Ministrisë së Financave, Koordinatorit Kombëtar dhe institucionet shtetërore ka themeluar një Grup Punues Qeveritar, Sekretariatit dhe Grupin Punues Teknik. Këto organe përbëhen nga përfaqësues të palëve të interesuara të sektorit publik, privat dhe të tretë. Detyra e tyre është të mbështesin hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018 bazuar në rezultatet e Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut 2013.

Qëllimet e Strategjisë Kombëtare 2014-2018 janë:

- Të mbështesë arritjen e objektivave të Programit Qeveritar të Republikës së Kosovës 2011-2014;

¹⁶ Raporti i Progresit 2013 Kosovë, Komisioni Evropian, 2013.

- Të reduktoj shkallën e ekonomisë joformale në 5% mes 2014 dhe 2018. Si rezultat, vlera e ekonomisë formale si subjekt i taksave dhe procedurave doganore do të rritet për të paktën 52 000 000 EUR¹⁷ deri më 31.12.2018. Kjo do të rriste volumin vjetor të të hyrave të kontrolluara;
- Të rris vlerën totale të konfiskimit të të ardhurave nga krimi. Për 2014 vlera e konfiskimit të të ardhurave nga krimi duket të rritet në 500 000 EUR. Gjatë 2015-2018 vlera e konfiskimit të të ardhurave nga krimi duhet të jetë 1000 000 EUR për vit.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar objektivat strategjike të mëposhtme të cilat janë një përgjigje kombëtare ndaj rreziqeve të identifikuar të ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare:

1. Ngritja e vetëdijes për ndikimet dhe parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimeve financiare;
2. Forcimi i parandalimit dhe luftës kundër ekonomisë joformale dhe krimit financiar duke rritur transparencën, përgjegjshmërinë, qeverisjes së mirë dhe partneritetit shoqëror;
3. Promovimi i procedurave të inteligjencës, hetimit, prokurorisë, gjykatave dhe procedurat për pastrimin e parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare;
4. Forcimi i kapacitetit të institucioneve përkatëse;
5. Zhvillimi dhe aplikimi i një qasjeje proaktive për bashkëpunimin ndërkombëtar sa i përket parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare;
6. Zhvillimi i legjislacionit kombëtar për të qen në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare dhe për të siguruar zbatimin e efikas të tij.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar një plan veprimi 2014-2018. Ky plan përbëhet nga gjithsejtë 51 aktivitete individuale (Shtojca 1), të cilat duhet të kryhen për arritjen e objektivave strategjike të Strategjisë kombëtare 2014-2018.

¹⁷ Vlera është bazuar në PBB-në në Kosovë nga 2012.

2. HYRJE

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014¹⁸ përbëhet nga katër shtylla kryesore. Ato janë:

1. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik;
2. Qeverisja e mirë dhe forcimi i sundimit të ligjit;
3. Zhvillimi i kapitalit njerëzor;
4. Mirëqenia sociale.

Arritja e këtyre objektivave kërkon parandalimin efikas të ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare. Prandaj, Qeveria e Republikës së Kosovës vendosi të krijojë një mekanizëm të menaxhimit të rrezikut për të trajtuar këto fenomene të dëmshme. Detajet e këtij procesi janë të përcaktuar në një Udhëzim Administrativ¹⁹ i cili përmbush kërkesat e menaxhimit të rrezikut të specifikuar në Rekomandimet e TFVF²⁰. Procesi si i tillë kryhet sipas Standardeve Ndërkombëtare ISO 31000²¹. U vendos që kriteret e rrezikut duhet të pasqyrojnë vlerat dhe objektivat e legjislacionit përkatës kombëtar dhe të shoqërisë në tërësi. Prandaj, kriteret e rrezikut janë nxjerrë nga Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit²² dhe Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011 - 2014²³ për të siguruar identifikimin e kërcënimeve dhe dobësitë që lidhen me ekonominë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare.

Menaxhimi i rreziqeve të ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë përbëhet prej vlerësimit të rrezikut, strategjisë dhe planit të veprimit, buxhetet dhe planet e performancës të institucioneve publike dhe platformën që siguron partneritet ndërmjet institucioneve të sektorit publik, privat dhe të tretë. Mekanizmi i krijuar është në përputhje me dokumentet e politikave të mëparshme, lidhur me parandalimin e këtyre dukurive të dëmshme. Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur të bashkojë strategjinë e nivelit kombëtar për ekonominë joformale dhe krimet financiare me ato të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Dokumentet e politikave merren parasysh gjatë hartimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018 janë si më poshtë:

- Programi Qeveritar dhe Plani i Veprimit për Parandalimin e Ekonomisë Joformale në Kosovë 2008 - 2009;
- Programi Qeveritar dhe Plani i Veprimit për të luftuar ekonominë joformale në Kosovë 2010 - 2012;
- Strategjia për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 2012-2015.

¹⁸ Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014, 2011.

¹⁹ Udhëzimi Administrativ MF - Nr. 04/ 2013 për Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut për pastrim të parave, dhe Financimin e terrorizmit, Ministria e Financave, 2013.

²⁰ Standardet Ndërkombëtare për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe shtimin (Rekomandimi TFVF-së), TFVF 2012.

²¹ Menaxhimi i Rrezikut – Parimet dhe udhëzimet, standardet Ndërkombëtare ISO 31000, 2009.

²² Ligji nr. 03/L-196 dhe ligji nr. 04/L-178 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, 2010 dhe 2013.

²³ Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014, 2011.

Në Kosovë, ekzistojnë disa strategji në nivel kombëtar, që kanë të bëjnë me parandalimin e krimit, madje edhe më shumë strategji që ndërlidhen me luftimin e ekonomisë joformale. Prandaj, është e domosdoshme të sigurohet koordinim të fortë gjatë hartimit, rishikimit, miratimit, zbatimit dhe monitorimit të këtyre politikave. Grupi Punues Qeveritar i themeluar për Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit 2014-2018 përbëhet nga përfaqësues të ministrive dhe institucioneve përkatëse. Prandaj, është deleguar një përgjegjësi për të koordinuar aktivitetet me strategjitë e tjera të ndërlidhura të nivelit kombëtar.

3. METODOLOGJIA DHE PËRKUFIZIMET

3.1. Metodologjia

3.1.1. E Përgjithshme

Planifikimi strategjik për parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë bazohet në menaxhimin e rrezikut. Kjo siguron që institucionet përkatëse kombëtare të jenë në gjendje të drejtojnë dhe kontrollojnë aktivitetet e tyre në lidhje me rreziqet e mundshme në të ardhmen.

Mekanizmi i menaxhimit të rrezikut mbështetet në konsultim dhe të komunikim të gjerë me partnerët, përfshirë institucionet më të rëndësishme të sektorit publik, privat dhe të tretë. Kjo është bërë me qëllim rritjen e partneritetit ndërmjet këtyre akterëve. Procedura e Menaxhimit të rrezikut është në përputhje me Udhëzimin²⁴ e Vlerësimit të rrezikut Kombëtar të TFVF-së për pastrimin e parasë dhe financimin e terrorizmit si dhe standardet ndërkombëtare ISO 31000²⁵ dhe 31010²⁶.

Mekanizmi i menaxhimit të rrezikut për ekonominë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë bazohet në standardet ndërkombëtare^{27,28,29}, dhe përbëhet nga instrumentet e mëposhtme:

- Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar 2013
- Strategjia Kombëtare 2014-2018;
- Plani i Veprimit i Strategjisë Kombëtare 2014-2018;
- Buxhetet dhe Planet e performancës të institucioneve relevante publike 2014-2018;
- Platforma e cila siguron partneritetin mes institucioneve shtetërore të sektorit publik, privat dhe të tretë sa i përket hartimit, rishikimit, miratimit, zbatimit dhe monitorimit të instrumenteve të menaxhimit të rrezikut.

Mekanizmi i menaxhimit të rrezikut mbështet vendimmarrjen duke marrë parasysh pasigurinë dhe mundësinë e ngjarjeve ose rrethanave të ardhshme dhe efektet e tyre. Objektivat e Strategjisë Kombëtare 2014-2018 janë masa të trajtimit për të identifikuar rreziqet e nivelit kombëtar të ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë.

Plani i Veprimit është një udhërrëfyes i cili duhet të ndiqet për të arritur objektivat e Strategjisë Kombëtare 2014-2018. Ai përfshin aktivitete konkrete dhe të matshme.

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare 2014-2018 është integruar në vendimmarrje në lidhje me buxhetet dhe planet e performancës së ministrive përgjegjëse dhe institucioneve publike.

²⁴Udhëzimi i TFVF për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të parasë dhe financimin e terrorizmit , 2013.

²⁵Menaxhimi i Rrezikut– Parimet dhe Udhëzimet, Standardet Ndërkombëtare ISO 31000, 2009.

²⁶Menaxhimi i Rrezikut– Teknikat e vlerësimit të rrezikut, Standardet Ndërkombëtare ISO 31010, 2009.

²⁷Menaxhimi i Rrezikut– Parimet dhe Udhëzimet, Standardet Ndërkombëtare ISO 31000, 2009.

²⁸Menaxhimi i Rrezikut– Teknikat e vlerësimit të rrezikut, Standardet Ndërkombëtare ISO 31010, 2009.

²⁹Udhëzimi i TFVF për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të parasë dhe financimin e terrorizmit, 2013.

Gjithashtu është e lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore të sektorit publik, privat dhe të tretë.

3.1.2. Planifikimi strategjik dhe procesi i menaxhimit të rrezikut në Kosovë

Hartimi, rishikimi, miratimi, zbatimi dhe monitorimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018 bazohen në metodologjinë e mëposhtme të aplikuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës:

1. Vlerësimi i rrezikut Kombëtar inicohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës;
2. Kriteret e rrezikut janë të përcaktuar. Ato duhet të pasqyrojnë vlerat dhe objektivat e legjislacionit përkatës kombëtar dhe të shoqërisë në tërësi. Kriteret e rrezikut janë nxjerrë nga Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit³⁰ dhe Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014³¹ për të siguruar identifikimin e kërcënimeve dhe cenueshmërisë në lidhje me pastrimin e parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe ekonomike si dhe ekonomisë joformale;
3. Duhet të identifikohen Institucionet e sektorit publik, privat dhe të tretë, të cilat duhet të përfshihen në zhvillimit të Vlerësimit të Rrezikut kombëtar;
4. Është mbledhur informacioni në lidhje me gjendjen e tanishme nga burimet e mëposhtme objektive përmes komunikimit dhe konsultimeve me partnerët e sektorit publik, privat dhe të tretë:
 - Mbledhja dhe analiza e statistikave që kanë të bëjnë me ekonominë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimin ekonomik dhe krimin financiar;
 - Mbledhja dhe analiza e raporteve të vlerësimit lidhur me funksionalitetin e kornizës përkatëse ligjore dhe mekanizmat tjerë për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimin financiar dhe ekonominë joformale;
 - Vlerësimi i strategjive në nivel kombëtar dhe planeve të veprimit të cilat kanë të bëjnë me parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare;
5. Është mbledhur informacioni në lidhje me gjendjen e tanishme nga burimet e mëposhtme objektive përmes komunikimit dhe konsultimeve me partnerët e sektorit publik, privat dhe të tretë:
 - Takimet dhe punëtoritë e Grupit punues të Vlerësimit Kombëtar të rrezikut;
 - Takimet dhe punëtoritë e Grupit punues qeveritar, Sekretariatit dhe Grupit Teknik Punues i themeluar për hartimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018;
 - Pyetësorë bazuar në internet (409 përgjigje) për institucionet përkatëse të sektorit publik, privat dhe të tretë³²;

³⁰ Ligji nr. 03/L-196 dhe Ligji nr. 04/L-178 për Parandalimin e Pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, 2010 dhe 2013.

³¹ Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014, 2011.

³²Raporti i rezultateve të pyetësorëve të bazuar në internet, ekipi i Projektit, Kontrata EuropeAid/132399/C/SER/XK.

- Intervistat (53 ekspertë) dhe takime me përfaqësues të institucioneve përkatëse publike, të sektorit privat dhe të tretë;³³;
- 6. Besueshmëria e burimit të informacionit dhe cilësia e informacionit të mbledhur vlerësohet duke përdorur sistemin 4x4 të Europolit;³⁴;
- 7. Kërcënimet dhe cenueshmëritë listohen në bazë të informacionit të mbledhur nëpërmjet komunikimit dhe konsultimeve me partnerët relevant;
- 8. Rreziqet janë identifikuar dhe klasifikuar në bazë të informacionit të mbledhur dhe vlerësuar;
- 9. Pasojat dhe gjasat e çdo rreziku të vetëm identifikuar analizohen veç e veç;
- 10. Rreziqet e identifikuar janë prioritet dhe masat e tyre të trajtimit përcaktohen gjatë fazës së vlerësimit;
- 11. Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar 2013 do të jetë bazë për objektivat e Strategjisë Kombëtare 2014-2018. Kjo do të sigurojë menaxhimin e rreziqeve. Masat e trajtimit të rreziqeve të identifikuar përbëjnë objektivat strategjike;
- 12. Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar 2013 do të rezultojë në një listë të veprimeve që duhet të kryhet me qëllim të zbatimit të masave të trajtimit të rreziqeve të identifikuar. Këto aktivitete do të jenë bazë për Planin e Veprimit 2014-2018;
- 13. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018 bazuar në Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut ;
- 14. Qeveria e Republikës së Kosovës mbështetet nga Ministria e Financave, Koordinatorin Kombëtar dhe institucionet relevante shtetërore të sektorit publik, privat dhe të tretë në hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018;
- 15. Qeveria e Republikës së Kosovës themelon Grupin Punues Qeveritar, Sekretariatit dhe Grupin Punues Teknik të përbërë nga përfaqësues të institucioneve të sektorit publik, privat dhe të tretë për të mbështetur në hartimin, rishikimin, miratimin, implementimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planin e Veprimit 2014-2018;
- 16. Rolet e kontribuesve janë të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit 2014-2018;
- 17. Procesi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018 , është vlerësuar duke përdorur monitorimin dhe funksionin e rishikimit të përcaktuar;
- 18. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit 2014-2018 rishikohen nëse konsiderohet e domosdoshme në bazë të funksionit mbikëqyrës dhe/ose proceset e vlerësimit të rrezikut;
- 19. Grupi Punues Qeveritar do të sigurojë koordinim me nivelin tjetër kombëtar dhe strategjitë të ndërlidhura sa i përket hartimit, rishikimit, miratimit, zbatimit dhe monitorimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018.

3.2. Përkufizimet

Rreziku

Rreziku është efekti i pasigurisë në objektiva.³⁵

³³ Lista e intervistave, takimeve, dhe punëtorive të organizuara nga Ekipet e Projektit, Kontrata EuropeAid/132399/C/SER/XK dhe Grupi Punues i Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar, 2013.

³⁴ Udhëzimet analitike, Europol, 2000.

³⁵ Menaxhimi i Rrezikut– Parimet dhe Udhëzimet, Standardet Ndërkombëtare ISO 31000, 2009.

Kriteret e rrezikut

Kriteret e rrezikut janë kriteret kundrejt të cilave vlerësohet rëndësia e një rreziku të veçantë. Normalisht ato bazohen në legjislacion, objektiva organizative ose instrumente të tjera të ngjashme.³⁶

Vlerësimi i Rrezikut

Vlerësimi i rrezikut është proces i përgjithshëm i identifikimit, analizës dhe vlerësimit të rreziqeve.³⁷

Menaxhimi i Rrezikut

Menaxhimi i Rrezikut paraqet aktivitetet e koordinuara për të drejtuar dhe kontrolluar organizatën sa i përket rrezikut.³⁸

Pastrimi i parave

Pastrimi i parave nënkupton³⁹ çdo sjellje me qëllim të maskimit të origjinës së parave apo pronave të tjera të fituara nga një vepër penale dhe përfshin:

1. Konvertimin ose çdo transferim të parave apo pronave të tjera që rrjedhin nga veprimtaria kriminale;
2. Fshehjen ose maskimin e natyrës së vërtetë, origjinës, vendndodhjes, sistemimit, lëvizjes, pronësisë ose të të drejtave në lidhje paratë ose pronën tjetër që rrjedhin nga aktivitetet kriminale.

Financimi i Terrorizmit

Financimi i Terrorizmit nënkupton⁴⁰ ofrimin ose mbledhjen e fondeve, me çfarëdo mjeti, drejtpërdrejt ose tërthorazi me qëllim që ato të përdoren ose të ketë njohuri se ato kanë për t'u përdorur, plotësisht ose pjesërisht, me qëllim që të kryen një nga veprat penale sipas nenit 138 të Kodit Penal të Kosovës dhe brenda përcaktimeve të veçanta të parashikuara në rekomandimet e TFVF-së.

Krimet financiare

Krimet financiare përfshijnë krimet ekonomike dhe financiare të definuara nga Grupi punues i Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar.⁴¹

Ekonomia joformale

Ekonomia joformale përbëhet nga ekonomia joformale e hirt dhe ekonomia joformale e zezë.

³⁶ Po aty.

³⁷ Po aty.

³⁸ Po aty.

³⁹ Neni 2 i Ligjit nr. 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, 2010.

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Lista e krimeve financiare dhe ekonomike të përcaktuara nga Grupi punues i Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit, 2013.

Ekonomia joformale e hirt

Ekonomia joformale e hirt përbëhet nga aktivitetet që janë produktive dhe ligjore, por me qëllim të fshehjes nga autoritetet publike për të shmangur pagesën e tatimeve dhe/ose kontributeve të sigurimeve shoqërore ose të jenë në pajtueshmëri me rregulloret. Të hyrat nga ekonomia joformale e hirt duhet të taten. Ky përkufizim është në përputhje me atë të OBZHE-së.⁴²

Ekonomia joformale e zezë

Ekonomia e zezë përbëhet prej të hyrave nga krimi. Kjo përfshin ato aktivitete prodhuese që gjenerojnë mallra dhe shërbime të ndaluara me ligj ose që janë të paligjshme, kur kryhen nga prodhuesit e paautorizuar. Ky përkufizim është në përputhje me atë të OBZHE-së.⁴³

⁴² Matja e Ekonomisë së pa vëzhguar – A Doracaku', OBZHE, 2002.

⁴³ Matja e Ekonomisë së pa vëzhguar – A Doracaku', OBZHE, 2002.

4. HISTORIATI DHE ANALIZAT

4.1. Angazhimi i Qeverisë për të luftuar kundër ekonomisë joformale, pastrimit të parase, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare

Qeveria e Republikës së Kosovës ka treguar vullnet për të luftuar kundër këtyre dukurive të dëmshme. Kjo është bërë duke hartuar dhe zbatuar një sërë ligjesh shtetërore në përputhje me standardet ndërkombëtare si dhe duke krijuar mekanizmin për menaxhim të rrezikut, përfshirë këtu strategjinë e cila përbën udhërrëfyesin për institucionet përkatëse të sektorit publik, privat dhe të tretë.

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014 përcakton prioritetet kryesore të nivelit shtetëror. Arritja e këtyre objektivave kërkon parandalimin efikas të ekonomisë jo formale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare. Prioritetet kryesore kombëtare janë si më poshtë:

1. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik;
2. Qeverisja e mirë dhe forcimi i sundimit të ligjit;
3. Zhvillimi i kapitalit njerëzor;
4. Mirëqenia sociale.

4.2. Strategjitë Kombëtare për parandalimin e ekonomisë joformale dhe pastrimit të parase, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2008-2013

Programi i parë Qeveritar dhe Plani i Veprimit për Parandalimin e Ekonomisë Joformale në Kosovë u hartua për periudhën kohore 2008-2009. Ato përbëheshin nga aktivitetet të cilat konsideroheshin si të nevojshme gjatë parandalimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare. Këto dokumente të politikave janë rishikuar dhe ndryshuar për 2010-2012. Plani i fundit i Veprimit 2010-2012 përbëhej prej gjithsej 15 aktivitete. Institucionet përgjegjëse arritën të zbatojnë gjithsej 70% të këtyre aktiviteteve të planifikuara.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar një strategji të veçantë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për periudhën kohore 2012-2015. Ky dokument i politikave nuk ka Plan të veçantë të Veprimit.

Është konkluduar në bazë të Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar 2013 që ekonomia joformale, pastrimi i parave, financimi i terrorizmit dhe krimet financiare janë të lidhura në mënyrë të pandashme me njëri-tjetrin. Për këtë arsye, Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur të bashkojë Programin Qeveritar për Parandalimin e Ekonomisë Joformale në Kosovë dhe Strategjinë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në një strategji të përbashkët kombëtare për periudhën kohore 2014-2018

Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar një sërë strategjish tjera për parandalimin e krimet në nivel kombëtar dhe strategjitë e tjera të ndërlidhura. Ato përbëhen nga qëllimet të cilat janë të lidhura me ekonominë joformale, pastrim të parave, financim të terrorizmit dhe krimet financiare. Koordinimi i strategjive të nivelit kombëtar do të kryhen si pjesë e proceseve të menaxhimit të rrezikut të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Politikat të cilat duhet të shiqohen gjatë hartimit dhe zbatimit të Strategjisë Kombëtare 2014 - 2018 përfshijnë të paktën:

- Strategjia e Zhvillimit të Sektorit Privat 2013 - 2017;
- Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Krimit 2013-2017;
- Strategjia Kombëtare kundër korrupsionit 2012-2017;
- Strategjia Kombëtare kundër Krimit të Organizuar 2012-2017;
- Strategjia Kombëtare kundër Drogave 2012-2017;
- Strategjia Kombëtare kundër Terrorizmit 2012-2017;
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale 2010-2014;
- Strategjia Kombëtare kundër falsifikimeve 2012-2017;
- Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2011-2014;
- Strategjia Kombëtare për Migracionin 2012-2017;
- Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2012-2017.

4.3. Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar për Pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në Kosovë 2013

4.3.1. Objektiva dhe proceset

Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi një Udhëzim Administrativ për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar⁴⁴ të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ky udhëzim përcakton në detaje procesin e vlerësimit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Udhëzimi Administrativ është në përputhje me Rekomandimin e TFVF-së 1⁴⁵. Procesi i përcaktuar është bazë për administrimin e rrezikut të nivelit kombëtar dhe planifikimit strategjik sa i përket pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Qeveria e Republikës së Kosovës vendosi të përdorë rezultatet e rrezikut Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar për parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimeve financiare dhe ekonomike. Kjo për shkak të faktit se gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut është gjetur se këto fenomene të dëmshme janë të ndërlidhura me njëri-tjetrin.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka përcaktuar kriteret që do të përdoren për të vlerësuar rëndësinë e rreziqeve duke ndjekur standardet ISO 31000⁴⁶. Është vendos që kriteret e rrezikut duhet të pasqyrojnë vlerat dhe objektivat e legjisllacionit përkatës kombëtar dhe të shoqërisë në tërësi. Prandaj, kriteret janë nxjerrë nga Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit⁴⁷ si dhe Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011 - 2014⁴⁸ për të siguruar identifikimin e kërcënimeve dhe cenueshmërisë në lidhje me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimeve financiare dhe ekonomike si dhe ekonominë joformale. Rreziqet përcaktuara nga vlerësimi i rrezikut kombëtar 2013 janë si në vijim:

⁴⁴ Udhëzimi Administrativ MF - Nr. 04/ 2013 për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar për pastrim të parasë, dhe Financimin e terrorizmit, Ministria e Financave, 2013.

⁴⁵ Standardet Ndërkombëtare për luftimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit dhe shtimin (Rekomandimi TFVF-së), TFVF 2012.

⁴⁶ Menaxhimi i Rrezikut– Parimet dhe Udhëzimet, Standardet Ndërkombëtare ISO 31000, 2009.

⁴⁷ Ligji nr. 03/L-196 dhe ligji nr. 04/L-178 për parandalimin e pastrimit të parasë dhe financimin e terrorizmit, 2010 dhe 2013.

⁴⁸Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014, 2011.

1. Parandalimi dhe zbulimi efikas i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
2. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik;
3. Qeverisja e mirë dhe forcimi i sundimit të ligjit;
4. Zhvillimi i kapitalit njerëzor;
5. Mirëqenia sociale.

4.3.2. Rreziqet e identifikuara në nivelin nacional në përgjithësi

Vlerësimi i Rrezikut Kombëtarë 2013 ka gjeneruar një listë me prioritete të përbërë nga gjithsej 35 rreziqe të identifikuara të cilat janë klasifikuar në kërcënimet dhe dobësitë që lidhen me ekonominë joformale, pastrim të parave, financim të terrorizmit dhe krime financiare. Rreziku më i lartë përbëhet nga ngjarjet dhe pasojat e mëposhtme:

1. Efikasiteti i performancës të procedurave të planifikimit të sektorit publik;
2. Efikasiteti i parandalimit dhe zbulimit të mekanizmave të korrupsionit, krimeve të tjera financiare dhe ekonomisë joformale në Kosovë dhe ndikimet e tyre në investimet ndërkombëtare dhe rritjen ekonomike;
3. Efikasiteti i zbatimit të kornizës ligjore;
4. Mbulimi i akteve nënligjore dhe procedurave standarde të veprimit;
5. Efikasiteti i rimëkëmbjes së pasurive dhe procedurat e konfiskimit;
6. Efikasiteti i zbatimit të vendimeve të konfiskimit, sanksioneve administrative dhe procedurave të falimentimit;
7. Kapaciteti dhe shkathtësitë e gjyqësorit;
8. Transparenca dhe llogaridhënia në administratën publike;
9. Nepotizmi;
10. Shkalla e ekonomisë joformale;
11. Ndikimet e ekonomisë të bazuar në para të gatshme;
12. Cenueshmëria e Kosovës ndaj krimeve financiare;
13. Cenueshmëria e Kosovës ndaj pastrimit të parave;
14. Natyra e veprave penale për pastrim parash;
15. Shtrirja e kriminalitetit të fshehur si i përket pastrimit të parave dhe krimeve të tjera financiare;
16. Funksionalizimi i mekanizmit të raportimit mbi transaksionet e dyshimta dhe transaksionet në para të gatshme;
17. Cenueshmëria e sektorëve të caktuar ndaj ekonomisë joformale si dhe krimeve me para dhe krimeve të tjera financiare dhe ekonomike..

4.3.3. Rreziqet që lidhen me ekonominë joformale

Vlerësimi i Rrezikut Kombëtarë 2013 është i bazuar në komunikimin gjithëpërfshirës dhe konsultimet me palët relevante kombëtare. Ky proces tregoi se përgjithësisht konsiderohet se Kosova është e cenueshme ndaj ekonomisë joformale. Ka disa faktorë që rrisin këtë rrezik. Komunikimi dhe konsultimi me palët e interesuara veçanërisht nënvizuan ngjarjet dhe pasojat e mëposhtme:

1. Ekonomia në Kosovë është kryesisht e bazuar në para të gatshme⁴⁹;

⁴⁹ Memorandumi ekonomik i shtetit të Kosovës, Banka Botërore, 2010.

2. Ekonomia në Kosovë ka një bazë shumë të ultë të eksportit dhe është e koncentruar më së shumti në shërbime dhe bujqësi të kryera nga ndërmarrjet e vogla (1-9 të punësuar) që përfaqësojnë përafërsisht 98.4 %⁵⁰ të të gjitha bizneseve;
3. Shkalla e lartë e papunësisë (30.9 %)⁵¹;
4. Kontrabandimi i mallrave të ligjshme;
5. Sektorët më të rrezikuara ndaj ekonomisë joformale kanë nevojë për mbështetje për krijimin, zbatimin dhe kontrollin e procedurave të tyre të brendshme të pajtueshmërisë.

4.3.4. Rreziqet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet financiare

Kosova është e ndjeshme ndaj krimeve financiare. Ky përfundim bazohet në komunikimin dhe konsultimin me palët relevante kombëtare gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut. Kontribuuesit konsiderojnë se korrupsioni, kontrabanda e mallrave të ligjshme, krimet që lidhen me prokurimin, vepra penale tatimore dhe krimet të lidhura me procesin e privatizimit janë krimet më të zakonshme financiare në Kosovë.

Megjithatë, rezultatet e Vlerësimit të Rrezikut Kombëtarë 2013 tregoi se pastrimi i parave, financimi i terrorizmit dhe të krimet e tjera ekonomike dhe financiare janë konsideruar se përbëjnë pjesën më të madhe të krimeve të fshehura. Ky ishte mendimi i përfaqësuesve të sektorit publik, privat dhe të tretë. Ata vlerësuan se korrupsioni, shkeljet tatimore, krimet në lidhje me prokurimin dhe procesin e privatizimit, kontrabandën dhe krimet tjera financiare si dhe krimet e drogës janë veprat më të zakonshme dhe kryesore penale të pastrimit të parave.

4.4. Informacioni statistikor në lidhje me ekonominë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë

4.4.1. Shkalla e ekonomisë joformale

Bashkimi Evropian, FMN-ja dhe Banka Botërore janë në mesin e organizatave të tjera ndërkombëtare, që mbështesin studimet në vende dhe rajone të ndryshme për matjen e ekonomisë joformale. Qëllimi është për të nxitur reduktimin progresiv të këtij fenomeni. Niveli i ekonomisë joformale në global⁵² është vlerësuar të jetë i barabartë me 33% të PBB globale dhe madhësia mesatare në BE⁵³ ishte 18.5% në vitin 2012.

Kalkulimet e fundit makroekonomike sa i përket ekonomisë joformale në Kosovë janë nga viti 2007. Ekipi i një Projekti të BE-së⁵⁴ ka vlerësuar se shkalla e ekonomisë joformale në Kosovë gjatë 2004-2006 ishte 26.67 – 34.75% të PBB-së së Kosovës. Në vlera absolute është varion mes 605 000 000 EUR dhe 793 000 000 EUR në vit. Megjithatë, e njëjta shkallë e ekonomisë joformale do të thoshte një vlerë absolute mes 1 312 678 800 EUR dhe 1 691 241 600 EUR në

⁵⁰ Strategjia e Zhvillimit të Sektorit Privat 2013 - 2017, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të Kosovës 2013.

⁵¹ Studimi i Fuqisë Punëtore në Kosovë, Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2013.

⁵² Moduli në Ekonominë Hije, Friedrich Schneider, 2011.

⁵³ Platforma Evropiane për të rritur bashkëpunimin evropian në parandalimin dhe ndalimin e punës së padeklaruar, Udhërrëfytyesi i Komisionit Evropian, 04/2013.

⁵⁴ Studimi në Shkallën dhe Parandalimin e Ekonomisë Joformale dhe Pastrimit të Parave në Kosovë, Projekt i BE-së 05KOS01/03/03/001, 2007.

vitin 2012⁵⁵. Një studim përshirë kompanitë është bërë në Kosovë në vitin 2013 për të vlerësuar shkallën e ekonomisë joformale.⁵⁶ Përfundimi i këtij studimi ishte 34.4% e PBB-së.

Shkalla e ekonomisë joformale në Kosovë është vlerësuar të jetë në të njëjtin nivel si në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Vlerësimet e fundit në rajon përfshijnë periudhën kohore 2006-2012. Rezultatet janë të specifikuar në Tabelën 1 më poshtë.

Tabela 1 Ekonomia joformale në Kosovë krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor në% të PBB-së

Vlerësuesi	Shqipëria	Bosnja & Hercegovina	Maqedonia	Kosova	Mali i Zi	Serbia
Ekonomia joformale në Ballkanin Perëndimor 2006-2012	37.7 ⁵⁷	35.4 ⁵⁸	38.8 ⁵⁹	26.7-34.4 ⁶⁰	23 ⁶¹	30 ⁶²

Burimi: Raportet e vlerësimit janë të specifikuar në fusnotat e mëposhtme

4.4.2. Ndikimet e ekonomisë joformale

Shuma totale e të hyrave të përcaktuara në buxhetin e Qeverisë së Republikës së Kosovës është rritur gjatë vitit 2008-2012 nga 0,976 në 1,538 miliardë euro. Të ardhurat doganore kanë përfaqësuar 54,9 - 63,5% të shumës totale dhe të ardhurat nga taksat 17,9 - 22,7%. Llojet e të ardhurave dhe pesha e tyre në buxhet janë të përcaktuara në tabelën më poshtë.

Tabela 2 Llojet e të hyrave dhe pesha e tyre në buxhetin e Qeverisë së Kosovës 2008-2012

Lloji i të hyrave	2008	2009	2010	2011	2012
Të hyrat nga tatimi	0,222	0,206	0,221	0,261	0,284
Të hyrat nga Dogana	0,605	0,635	0,701	0,828	0,845
Të hyrat tjera	0,149	0,304	0,257	0,214	0,408
Të hyrat në total	0,976	1,145	1,179	1,303	1,538

⁵⁵ Bruto Produkti Vendor i Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2013.

⁵⁶ Perspektivë Biznesore e Informalitetit në Kosovë Friedrich Ebert Stiftung dhe Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur dhe Instituti Riinvest për Hulumtime dhe Zhvillim, 2013.

⁵⁷ Vlerësimet e reja për ekonominë në hije në të gjithë botën, Schneider-Buehn-Mali i Zi, 2010.

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ Po aty.

⁶⁰ Hulumtimi mbi shtrirjen e Ekonomisë Jo-legale dhe Parandalimin e saj si dhe Pastrimi i Parave në Kosovë, projekt i BE 05KOS01/03/03/001, 2007.

⁶¹ Trajtimi i punës së pashpallur në Mal të Zi, Fondacioni European për Përmirësimin e Kushteve të Punës dhe Jetesës, 2013.

⁶² Ekonomia në Hijë në Serbi (2010), Fondacioni për Avancimin e Ekonomisë, 2013.

Ekonomia joformale ka ndikim në të hyrat. Kjo në radhë të parë ka të bëjë me fondet e mbledhura nga Administrata Tatimore. Qeveria e Republikës së Kosovës ka nevojë të zgjeroj bazën tatimore dhe të rrit nivelin e të ardhurave nga tatimet.

4.4.3. Shkalla e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimet financiare

Si pjesë e hartimit të Vlerësimit të Rrezikut Kombëtarë 2013, Grupi Punues për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar me mbështetjen e Ekipit të Projektit të financuar nga BE-ja⁶³ ka krijuar një listë që përbëhet nga krimet të cilat janë konsideruar se përbëjnë pastrim të parave, financim të terrorizmit dhe krimeve të tjera ekonomike dhe financiare në Kosovë. Qëllimi ishte të përgatitet një analizë statistikore për vlerësimin e rrezikut në bazë të informacionit të mbledhur nga autoritetet përkatëse. Ekspertët kërkuan informacion lidhur me:

- Numri dhe lloji i krimeve financiare të zbuluara nga autoritetet për një vit kalendarik;
- Numri dhe lloji i krimeve financiare të përfshira në akuzat për një vit kalendarik;
- Numri dhe lloji i krimeve financiare të përfshira në dënime për një vit kalendarik;
- Numri dhe vlera e masave të sekuestrimit të përkohshëm të shfrytëzuara për hetimin e krimeve financiare për një vit kalendarik;
- Numri dhe vlera e dënimeve të sekuestrimit në bazë të krimeve financiare për një vit kalendarik.

Grupi Punues për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar dhe Ekipi i Projektit të financuar nga BE-ja⁶⁴ ka marrë statistikën⁶⁵ nga Policia e Kosovës⁶⁶, Dogana e Kosovës⁶⁷ dhe Këshillit Gjyqësorë të Kosovës⁶⁸. Rezultatet e vlerësimit që mbulojnë vitet 2008 – 2012 janë si në vijim:

⁶³ Projekt i financuar nga BE, EuropeAid/132399/C/SER/XK, 2013.

⁶⁴ Po aty.

⁶⁵ Grupi Punues për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar dhe Ekipi i Projektit të financuar nga BE-ja ka kërkuar statistikën nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Këshilli Gjyqësorë i Kosovës.

⁶⁶ Krimet financiare të regjistruara nga Policia e Kosovës 2008-2012, projekt i financuar nga EuropeAid/132399/C/SER/XK, 2013.

⁶⁷ Krimet financiare të regjistruara nga Dogana e Kosovës 2008-2012, projekt i financuar nga EuropeAid/132399/C/SER/XK, 2013.

⁶⁸ Krimet financiare të regjistruara nga Këshilli Gjyqësorë i Kosovës 2008-2012, projekt i financuar nga EuropeAid/132399/C/SER/XK, 2013.

Tabela 2: Krimet financiare të regjistruara nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës 2008-2012

Hetimet e iniciuara të krimeve financiare	2008	2009	2010	2011	2012	Total
Policia	3 043	2 123	2 774	2 914	2 135	12 989
Dogana	90	57	64	69	49	329
Gjithsej	3 133	2 180	2 838	2 983	2 184	13 318
Dënimet e krimeve financiare	2008	2009	2010	2011	2012	Total
Gjykatat themelore ⁶⁹	1 391	1 541	1 298	1 318	1 339	6 887

Burimi: Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 2013

Analizat statistikore të kryera gjatë Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar 2013 tregoi se mashtrimet, falsifikimi i të hollave, kontrabanda e mallrave dhe pushtimi i paligjshëm i pasurive të patundshme janë krimet më të zakonshme financiare të njohura gjatë procedurës penale⁷⁰.

4.4.4. Ndikimi i pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare

Ekipi i Projektit i financuar nga BE-ja⁷¹ ka vlerësuar në vitin 2007 madhësinë e ekonomisë së zezë në Kosovë në mes të viteve 2004 dhe 2006. Vlera minimale, duke përfshirë fitimet nga krimet e drogës, kundërvajtjet tatimore, kontrabandës dhe prostitucionit, është vlerësuar të jetë në mes të 301-386 milion euro në vit. Megjithatë, nuk ka llogaritje të mëvonshme në lidhje me shkallën e ekonomisë së zezë. Për më tepër, nuk ka statistika të besueshme lidhur me numrin vjetor dhe vlerën e vendimeve të sekuestrimit të përkohshëm dhe vendimeve të gjykatës për konfiskim në lidhje me të ardhurat nga krimi.

Agjencia për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar është themeluar në vitin 2010. Ajo mban statistika lidhur me numrin e përgjithshëm dhe vlerën e vendimeve për sekuestrim të përkohshëm dhe vendimeve të gjykatës për konfiskim në bazë vjetore. Agjencia për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar nuk ka specifikuar informacionin lidhur me krimet financiare. Statistikat e agjencisë janë si më poshtë:

⁶⁹ Gjykatat Themelore nga 2013 dhe tutje dhe Gjykatat Kounale 2008-2012.

⁷⁰ Krimet financiare të regjistruara nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Këshilli Gjyqësorë i Kosovës 2008-2012, Grupi Punues i Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut dhe projekti i financuar nga BE-ja EuropeAid/132399/C/SER/XK, 2013.

⁷¹ Hulumtimi mbi Shkallën dhe Preventivën e Ekonomisë Jo-legale dhe Pastrimit të Parave në Kosovë, projekti i financuar nga BE-ja 05KOS01/03/03/001, 2007.

Tabela 3: Vlera e mjeteve të sekuestruara dhe të konfiskuara menaxhuar nga Agjencia për Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruar dhe të Konfiskuar 2008-2012

Masat ligjore në lidhje me fitimet nga krimi	2008	2009	2010	2011	2012	Total
Sekuestrimi i përkohshëm	N/A	N/A	0€	28 528€	28 2918€	311 446€
Konfiskimi	N/A	N/A	1 720€	27 390€	29 926€	59 036€

Burimi: Agjencia për Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruar dhe të Konfiskuar, 2013

Informacioni në dispozicion vërteton se vlera e përgjithshme e fitimeve të sekuestruara dhe të konfiskuara nga krimi kanë qenë të ultë, vetëm 29 926 euro në vitin 2012.⁷²

4.5. Konkluzionet për shkallën dhe ndikimet e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë

4.5.1. Ekonomia joformale

Shkalla e ekonomisë joformale në Kosovë është llogaritur të jetë 26.67% – 34.75% e PBB-së. Gjatë periudhës 2008 – 2014, vlerëa e vlerësuar është siç është definuar në Tabelën 5 më poshtë.

Tabela 5: Vlera e vlerësuar e ekonomisë joformale në Kosovë gjatë 2008-2012

Vlera nga PBB	2008	2009	2010	2011	2012
Minimum	1 052 066 500€	1 070 079 400€	1 145 735 400€	1 275 224 600€	1 312 678 800€
Maksimum	1 355 471 500€	1 378 679 100€	1 476 153 500€	1 642 986 000€	1 691 241 600€

Burimi: Produkti i Brendshëm Bruto për aktivitete 2006 – 2012, Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2013

Shkalla e Ekonomisë Joformale dëmton Interesat fiskale të qeverisë duke shkaktuar rënie të ardhurave. Prandaj, kjo do të dobësojë infrastrukturën kombëtare dhe aftësinë e shoqërisë për të ofruar shërbime publike.

Ndikimet e ekonomisë joformale nuk janë të kufizuar në sektorin publik, por gjithashtu ndikojnë në aktivitetet e biznesit. Ekonomia joformale dëmton konkurrencën e ndershme dhe ul konkurrencën në mes të kompanive. Kostot e prodhimit të kompanive që përpjekjen për të shmangur aktivitetet joformale janë më të larta për shkak të mbledhjes joadekuate të tatimeve. Përdorimi i punës joformale dhe evazioni sistematik i kontributeve të sigurimeve shoqërore bëhet një domosdoshmëri që dobëson mbrojtjen e punonjësve dhe ul përfitimet e tyre sociale.

⁷² Statistikat 2010-2012, Agjencia për Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, 2013

Kjo sigurisht do të shtrembërojë qëndrimet e përgjithshme në shoqëri dhe çon në një prirje të rëndësishme për shmangien e taksave. Jo-formaliteti do të dobësojë besueshmërinë e sistemit të financimit. Nën-deklarimi i fitimit pengon besimin në mes të kompanive dhe bankave, duke çuar në një treg joefikas të kredive. Kjo nga ana tjetër pengon investimet nga kompanitë e huaja.

Në Kosovë, është e rëndësishme për të zgjeruar bazën tatimore. Duhet të identifikohen masa të cilat janë të nevojshme për të reduktuar efektet e dëmshme anësore të ekonomisë të bazuar në para të gatshme. Kjo është padyshim një nga sfidat kryesore në parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare. Nga ana tjetër, ekonomia e Kosovës ka një bazë shumë të ulët të eksportit dhe ajo është përqendruar kryesisht në shërbime dhe bujqësi të kryera nga ndërmarrjet e vogla (1-9 punëmarrës). Këta sipërmarrës janë të cenueshëm ndaj ekonomisë joformale dhe ata duhet të mbështeten për të reduktuar këtë fenomen të dëmshëm. Kjo do të ketë një ndikim pozitiv në normën e lartë të papunësisë e cila për momentin e rrit ekonominë joformale në Kosovë.

Vlerësimi i Rrezikut Kombëtarë 2013 përcakton rreziqet të cilat janë të lidhura me ekonominë joformale dhe Plani i saj i Veprimit përbëhet prej masave të nevojshme të trajtimit. Këto dokumente të politikave janë baza e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018.

4.5.2. Pastrimi i Parave, financimi i terrorizmit dhe krimet financiare

Institucionet kombëtare konsideruan se krimet financiare për pjesën më të madhe janë krime të fshehura⁷³. Të gjeturat të bazuara në Vlerësimin e Rrezikut Kombëtarë 2013 dhe analizat e informacionit në dispozicion të statistikave në lidhje me krimet financiare gjatë periudhës 2008 – 2012 tregojnë se:

- Numri vjetor i krimeve financiare të zbuluara nga policia dhe dogana është në rënie;
- Krimet më të zakonshme financiare të zbuluara nga policia dhe dogana janë mashtrime, falsifikim i parasë dhe kontrabanda e mallrave;
- Numri vjetor i dënimeve për krime financiare ka mbetur afërsisht në të njëjtin nivel;
- Krimet më të shpeshta financiare për të cilat gjykatat themelore janë duke dhënë dënime janë mashtrimet, uzurpimi i paligjshëm i pasurive të patundshme dhe falsifikimi i parave;
- Numri vjetor i krimeve financiare të përcaktuara në dënime janë 51.7% e krimeve financiare të zbuluara nga Policia e Kosovës dhe Dogana e Kosovës;
- Nuk ka asnjë informacion për numrin dhe vlerën e masave të sekuestrimit të përkohshëm të përdorura për hetimin e krimeve financiare;
- Nuk ka asnjë informacion për numrin dhe vlerën e vendimeve të konfiskimit të cilat janë bazuar në krimet financiare;
- Vlera totale e të ardhurave të konfiskuara nga krimi në përgjithësi është në nivel të ulët duke qenë vetëm 29 926 euro në vitin 2012;
- Informacioni statistikor në lidhje me procedurën penale për krimet financiare nuk është i saktë.

Sa i përket procedurës penale lidhur me krimet financiare në Kosovë, është e qartë se duhet të zhvillohen funksionet e përbashkëta të zbulimit për të rritur cilësinë e informacionit dhe zbulimin

⁷³ Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar për Pastrim Parash dhe Financim të Terrorizmit në Kosovë 2013, Qeveria e Kosovës, 2013.

e krimeve. Kjo ka të bëjë me veprat penale veçanërisht të rënda. Procedura penale duhet të bazohet në hetimet e udhëhequra të zbulimit dhe procedurave që synojnë sigurimin e caktimit të prioriteteve dhe bashkëpunimin efektiv me shumë agjenci. Nga ana tjetër, hulumtimi i pasurive dhe procedurat e konfiskimit duhet të organizohen në mënyrë më efektive. Vlera e të ardhurave të kthyera nga krimi duhet të rritet.

Vlerësimin e Rrezikut Kombëtarë 2013 përcakton rreziqet të cilat janë të lidhura me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare dhe Plani i saj i Veprimit përbëhet prej masave të nevojshme të trajtimit. Këto dokumente të politikave janë baza e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018.

5. QËLLIMET DHE OBJKETIVAT E STRATEGJISË KOMBËTARE 2014-2018

5.1. E përgjithshme

Qëllimet, objektivat dhe veprimet e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018 janë të bazuara në Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut 2013. Këto dokumente të politikave përbëjnë një mekanizëm të menaxhimit të rrezikut për rreziqet e nivelit kombëtar të ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë. Qëllimi kryesor i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të saj të Veprimit 2014-2018 është të mbështes arritjen e objektiveve të Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014 që janë:

1. Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik;
2. Qeverisje e mirë dhe fuqizim i Sundimit të Ligjit;
3. Zhvillim i kapitalit njerëzor;
4. Mirëqenia sociale.

Arritja e këtyre objektivave të nivelit kombëtar kërkon parandalim efikas të ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit 2014-2018 janë gjithashtu duke mbështetur Kosovën në përmbushjen e angazhimeve në procesin e stabilizimit dhe asociimit të pranimit në BE.⁷⁴

5.2. Qëllimet e Strategjisë Kombëtare 2014-2018

Dokumenti i Strategjisë identifikon, vlerëson dhe rekomandon një set të politikave dhe veprimeve për të arritur një prioritet apo qëllim të nivelit të veçantë kombëtar.⁷⁵ Kështu, qëllimet e Strategjisë Kombëtare janë:

- Të mbështes arritjen e objektivave të Programit Qeveritar të Republikës së Kosovës 2011-2014;
- Të reduktoj shkallën e ekonomisë joformale në 5% mes 2014 dhe 2018. Si rezultat, vlera e ekonomisë formale si subjekt i taksave dhe procedurave doganore do të rritet për të paktën 52 000 000 EUR⁷⁶ deri më 31.12.2018. Kjo do të rriste volumin vjetor të të hyrave të kontrolluara;
- Të rris vlerën totale të konfiskimit të të ardhurave nga krimi. Për 2014 vlera e konfiskimit të të ardhurave nga krimi duket të rritet në 500 000 EUR. Gjatë 2015-2018 vlera e konfiskimit të të ardhurave nga krimi duhet të jetë 1000 000 EUR për vit.

5.3. Objektivat e Strategjisë Kombëtare 2014-2018

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar objektivat strategjike të Strategjisë Kombëtare 2014-2018. Ata janë zbatuar përmes Planit të Veprimit. Objektivat strategjike janë si më poshtë:

1. Ngritja e vetëdijes mbi ndikimet dhe për parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimin financiar;

⁷⁴ Raporti i Progresit 2013 Kosovë, Komisioni Evropian, 2013.

⁷⁵ Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 në Procedurat, Kriteret dhe Metodologjinë për Përgatitjen dhe Miratimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve për Zbatimin e tyre, Qeveria e Republikës së Kosovës, 2013.

⁷⁶ Vlera është bazuar në PBB-në në Kosovë nga 2012.

2. Forcimi i parandalimit dhe luftës kundër ekonomisë joformale dhe krimit financiar duke rritur transparencën, përgjegjshmërinë, qeverisjen e mirë dhe partneritetin shoqëror;
3. Promovimi i zbulimit, hetimit, ndjekjes penale, gjykatave dhe të zbatimit të ndjekjes penale për pastrimin e parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare;
4. Forcimi i kapacitetit të institucioneve përkatëse;
5. Zhvillimi dhe aplikimi i një qasjeje pro-aktive për bashkëpunim ndërkombëtar për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare;
6. Zhvillimi i legjislationit kombëtar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe sigurimi i zbatimit të tij efikas.

5.4. ***Përshkrimi i detajuar i objektivave të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Ekonomisë Joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018***

5.4.1. Ngritja e vetëdijes mbi ndikimet dhe parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimit financiar

Përgjegjësia për rritjen e ndërgjegjësimit për natyrën, shtrirjen dhe ndikimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare i mbetet Qeverisë dhe autoriteteve përkatëse. Situata aktuale në Kosovë thekson nevojën për informacion të plotë dhe të saktë në lidhje me këto fenomene të dëmshme. Kjo është një domosdoshmëri nga perspektiva e brendshme dhe ndërkombëtare e vendit. Përfaqësuesit e sektorit publik, privat dhe të tretë theksojnë se vetëdija është një nga mjetet më të rëndësishme parandaluese.

5.4.2. Forcimi i parandalimit dhe luftës kundër ekonomisë joformale dhe krimit financiar duke rritur transparencën, përgjegjshmërinë, qeverisjen e mirë dhe partneritetin shoqërorë

Qeveria është kryesisht përgjegjëse për parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare. Është gjithashtu një detyrë e autoriteteve të tjera në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Transparenca dhe përgjegjshmëria e sektorit publik duhet të sigurohet.

Sektorët më të rrezikuar për ekonominë joformale, pastrim të parave, financim të terrorizmit dhe krime financiare duhet të mbështeten. Proceset e tyre të brendshme duhet të rriten në përputhje me parimin e qeverisjes së mirë.

Cilësia e mekanizmave kombëtar për parandalimin e ekonomisë joformale, pastrim të parave, financim të terrorizmit dhe krimeve financiare varet nga efikasiteti i bashkëpunimit mes sektorit publik, privat dhe të tretë. Ata të gjithë duhet të kenë njohuri në lidhje me detyrimet e tyre ligjore dhe aftësinë për të identifikuar dhe aftësinë për të parandaluar këto fenomene.

5.4.3. Promovimi i zbulimit, hetimit, ndjekjes penale, gjykatave dhe të zbatimit të ndjekjes penale për pastrimin e parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare

Në Kosovë, ka shumë autoritete përgjegjëse për zbulimin dhe hetimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare. Prandaj është e rëndësishme për procesin e rregullt ligjor dhe cilësinë e procesit penal në tërësi që bashkëpunimi, shkëmbimi i informacionit dhe koordinimi i aktiviteteve është e organizuar në mënyrë sistematike mes zbatuesve të ligjit, gjyqësorit dhe autoriteteve të tjera përkatëse. Procedurat e tyre strategjike dhe operative duhet të jenë në vend gjithashtu.

5.4.4. Forcimi i kapacitetit të institucioneve përkatëse

Duhet të sigurohet që institucionet përkatëse kanë burimet e duhura njerëzore, teknike dhe të tjera. Më e rëndësishmja, personeli duhet të ketë potencialin dhe aftësitë e nevojshme për mbajtjen e një regjimi efikas të parandalimit. Kapacitetet e institucioneve relevante duhet të rritet në përputhje me mandatet e tyre, përgjegjësitë dhe kërkesës në rritje të shërbimeve.

Krijimi i një regjimi funksional për parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare kërkon që sektori publik të promovoj bashkëpunimin me pjesëmarrjen e individëve, shoqërisë civile, organizatave joqeveritare, organizatave të bazuara në komunitet dhe subjekteve përkatëse private. Përfshirja e tyre në procesin e vendim-marrjes është e domosdoshme për zhvillimin e strategjive, politikave, standardeve dhe procedurave të dizajnuara për të mbrojtur shoqërinë si një tërësi. Sektori publik duhet të sigurojë që përfaqësuesit e sektorit privat dhe të tretë kanë njohuri në lidhje me detyrimet e tyre ligjore, aftësitë për të identifikuar dhe kapacitetin për të parandaluar ekonominë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare. Ata duhet gjithashtu të kenë mundësinë për të raportuar te autoritetet në lidhje me këto fenomene, si dhe të kenë qasje në informatat relevante lidhur me mekanizmat e parandalimit në dispozicion.

5.4.5. Zhvillimi dhe zbatimi i një qasjeje pro-aktive për bashkëpunim ndërkombëtar për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare

Parandalimi i pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare kërkon bashkëpunim efikas ndërkombëtarë. Prandaj është e rëndësishme që standardet e Kosovës të përputhen me standardet relevante ndërkombëtare dhe të merr pjesë në mënyrë intensive në punë në nivelin strategjik të organizatave ndërkombëtare. Hetimi i pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare dhe rimëkëmba e pasurive kërkojnë bashkëpunim të efektshëm ndërkombëtar në nivel operativ. Autoritetet shtetërore përgjegjëse për procedurën penale u duhen mekanizma të qartë dhe të shpejtë për ndihmë ligjore reciproke dhe shkëmbim ndërkombëtar të informacionit.

5.4.6. Zhvillimi i legjisllacionit kombëtarë për tu përshtatur me standardet ndërkombëtare dhe për të siguruar zbatimin e tij efikas

Parandalimi i pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare kërkon që korniza ligjore kombëtare në Kosovë të jetë në përputhje me standardet relevante ndërkombëtare. Legjisllacioni duhet të ndryshohet dhe të rishikohet për të siguruar proces të rregullt ligjor dhe përputhshmëri me kërkesat në bazë të mjedisit operativ dhe standardeve ndërkombëtare. Besueshmëria e regjimit të parandalimit kërkon që korniza ekzistuese ligjore të jetë e qartë dhe të zbatohet në mënyrë efikase. Përfaqësuesit e sektorit publik, privat dhe të tretë duhet të kenë aftësinë për të aplikuar legjisllacionin dhe për të kuptuar qëllimin e legjisllaturës.

6. ALTERNATIVAT E SHQYRTUARA

Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur për të menaxhuar rreziqet e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë. Një proces i vlerësimit të rrezikut është kryer duke zbatuar standardet ndërkombëtare ISO 31000⁷⁷ dhe 31010⁷⁸ dhe Udhëzuesin TFVF⁷⁹.

Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar 2013 është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në dhjetor të vitit 2013. Ajo identifikon rreziqet e paraqitura dhe përcakton masat e tyre trajtimit të tyre.

Objektivat dhe veprimet e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018 janë bazuar në Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar për Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit 2013. Këto dokumente të politikave përbëjnë një mekanizëm të menaxhimit të rrezikut në lidhje me këto fenomene të dëmshme në Kosovë.

Procesi i menaxhimit të rrezikut ka dëshmuar se ekonomia joformale, pastrimi i parave, financimi i terrorizmit dhe krimet financiare janë të lidhura me njëra-tjetrën në Kosovë. Ka një numër të çështjeve ndër-sektoriale në lidhje me luftimin e këtyre dukurive të dëmshme. Prandaj, Qeveria e Kosovës ka vendosur të bashkojë Programin Qeveritar për Parandalimin e Ekonomisë Joformale në Kosovë dhe Strategjinë për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Është themeluar një strategji e përbashkët kombëtare.

Procesi strategjik në nivel kombëtar i planifikimit për parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimeve duhet të mbështesë Qeverinë në arritjen e prioritetëve të saj kryesore. Nga ana tjetër, ajo duhet të jetë në konsekuent me mekanizmat e mëparshme dhe ekzistuese, objektivat e të cilave janë për të parandaluar fenomenet e dëmshme. Prandaj, Plani i Veprimit dhe Strategjia Kombëtar 2014-2018 janë në përputhje me objektivat e Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014, strategjitë aktuale në nivel kombëtar për parandalimin e krimit dhe Programet e mëparshme qeveritare për Parandalimin e Ekonomisë Joformale në Kosovë 2008 - 2009 dhe 2010-2012

E mira për të gjithë shoqërinë kërkon që administrata të ketë një aftësi për të mbrojtur interesat fiskale të shtetit, të siguroj për të punësuarit të drejtat ligjore dhe të siguroj konkurrencë të ndershme në jetën e biznesit. Nga ana tjetër masat e nevojshme për të trajtuar ekonominë joformale dhe krimin financiar janë të lidhura me sferat e disa ministrive dhe autoriteteve. Përveç kësaj, zbatimi i tyre kërkon partneritet transparent ndërmjet sektorit publik, privat dhe të tretë. Prandaj aktivitetet e zbatimit duhet të koordinohen për të garantuar zbatimin efektiv dhe financiarisht të justifikueshme. Një strategji në nivel kombëtar është një instrument optimal për këtë qëllim. Megjithatë, duhet të sigurohet që objektivat strategjikë janë të përfshirë në buxhetet dhe Planet e Performancës të institucioneve publike të obliguara. Përndryshe, procesi i zbatimit nuk do të jetë një pjesë e natyrshme e detyrave të tyre zyrtare.

⁷⁷ Menaxhimi i rrezikut - teknikat e vlerësimit të rrezikut, Standardet Ndërkombëtare ISO 31010, 2009.

⁷⁸ Menaxhimi i rrezikut – Parimet dhe udhëzimet, Standardet Ndërkombëtare ISO 31000, 2009.

⁷⁹ TFVF Udhëzime mbi Vlerësimin e Rrezikut Kombëtarë për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit, TFVF, 2013

Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitucional dhe Partneritetet e sektorit publik, privat dhe të tretë janë thelbësore në lidhje me themelimin, zbatimin dhe monitorimin e të gjitha strategjive në nivel kombëtar. Është pjesë e mekanizmit të menaxhimit të rrezikut. Grupi Punues Qeveritar përbëhet nga përfaqësues të të gjitha ministrive dhe institucioneve përkatëse. Prandaj është një detyrë specifike e këtij organi për të siguruar që masat në lidhje me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit 2014-2018 janë të koordinuara me strategjitë e tjera të nivelit kombëtar.

7. REKOMANDIMET

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare 2014-2018 është bazuar në Planin e Veprimit. Ai është një udhërrëfyes i cili duhet të ndiqet për të arritur objektivat strategjikë. Plani i Veprimit përfshin aktivitete konkrete dhe struktura e saj përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:

- "Objektivi strategjik", përcakton objektivin, zbatimi i të cilit mbështet veprimet e listuar;
- "Veprimi" përcakton veprimtarinë e cila ka për t'u zbatuar për të arritur objektivin strategjik;
- "Treguesi Kyç i Performancës" përcakton treguesit që përdoren për matjen e suksesit të procesit të zbatimit të aksionit në fjalë;
- "Institucioni përgjegjës" përcakton institucionin publik që ka përgjegjësinë kryesore për zbatimin e veprimit në fjalë dhe është i detyruar për të raportuar në lidhje me rezultatet e procesit të implementimit;
- "Institucionet mbështetëse" identifikon institucionet e sektorit publik, privat dhe të tretë që duhet të përkrahin institucionin përgjegjës gjatë zbatimit të veprimit në fjalë. Roli dhe përgjegjësitë e tyre duhet të specifikohen në planin lidhur me procedurën e zbatimit;
- "Afati kohor për zbatimin" përcakton orarin për procesin e zbatimit të veprimit në fjalë;
- "Kostot financiare dhe burimi i financimit" përcakton nëse procesi i zbatimit të veprimit në fjalë kërkon fonde shtesë dhe/ose një buxhet të veçantë. Burimi i financimit të mundshëm duhet të specifikohet;
- "Komentet" përshkruajnë detajet e veprimit lidhur me procesin e implementimit.

Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare 2014-2018 përbëhet nga **57** aktivitete individuale. I është bashkangjitur (Shtojca 1) kësaj strategjie.

8. HARTIMI, RISHIKIMI, MIRATIMI, ZBATIMI DHE MEKANIZMAT MONITORUES TË STRATEGJISË KOMBËTARE

8.1. E përgjithshme

Menaxhimi i rreziqeve në nivel kombëtar lidhur me ekonominë joformale, pastrimin e parasë, financimin e terrorizmit dhe krimin financiar është i bazuar në Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar 2013 dhe Strategjinë Kombëtare 2014-2018. Hartimi, rishikimi, miratimi, zbatimi dhe monitorimi i këtyre dokumenteve të politikave janë funksione të vazhdueshme. Këto procese janë transparente dhe bazohen në një raportim të rregullt të institucioneve të obliguara dhe me miratim të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

8.2. Kontribuuesit dhe rolet e tyre

8.2.1. Qeveria e Republikës së Kosovës

Qeveria e Republikës së Kosovës vendos për administrimin e rrezikut në nivel kombëtar lidhur me ekonominë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare. Ajo ka miratuar Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar 2013 në bazë të propozimit të Ministrisë së Financave. Qeveria e Republikës së Kosovës miraton edhe Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit 2014 - 2018 bazuar në propozimin e Grupit Punues Qeveritar.

8.2.2. Ministria e Financave

Ministria e Financave ka qenë përgjegjëse për hartimin e Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar 2013. Ajo ka paraqitur propozimin për miratimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ministria e Financave mban përgjegjësinë kryesore për koordinimin e aktiviteteve lidhur me hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018. Kjo detyrë është e ndërlidhur me përgjegjësitë tjera ligjore të saj. Ministria e Financave kryeson Grupin Punues Qeveritar, Sekretariatit dhe Grupin Punues Teknik të cilat janë themeluar për Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit 2014-2018. Ministria e Financave gjithashtu do të sigurojë këto organe me objektet dhe llojet e tjera të mbështetjes teknike që janë të nevojshme për punën e tyre.

8.2.3. Grupi Punues Qeveritar

Grupi Punues Qeveritar është përgjegjëse për hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018. Ajo do të paraqesë propozimet për miratimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Grupi Punues Qeveritar kryesohet nga Ministri i Financave. Anëtarët e tjerë janë:

- Ministri i Drejtësisë;
- Ministri i Punëve të Brendshme;
- Ministri i Tregtisë dhe Industrisë;
- Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale;
- Drejtori i Policisë së Kosovës;
- Drejtori i Doganës së Kosovës;
- Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës;
- Kryeprokurori i Shtetit;
- Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës;
- Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës;
- Drejtori i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit;
- Drejtori i Njësisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës.

Grupi Punues Qeveritar duhet të siguroj pjesëmarrjen e institucioneve relevante të sektorit privat dhe të tretë në implementimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018. Kjo duhet të bëhet duke i ftuar përfaqësuesit e tyre në mbledhjet e Grupit Punues Qeveritar në rast se konsiderohet e nevojshme nga këndvështrimi i çështjes në fjalë.

Grupi Punues Qeveritar raporton për gjetjet në lidhje me zbatimin dhe monitorimin e Planit Kombëtar të Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2014 - 2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës së paku dy (2) herë brenda një viti kalendarik dhe menjëherë nëse kërkojnë nevojat strategjike në ose operative.

Është thelbësore për të siguruar që strategjitë në nivel kombëtar dhe mekanizmat e tjerë të menaxhimit të rrezikut janë të organizuara në mënyrë të koordinuar. Kjo është për të shmangur mbivendosjen e aktiviteteve dhe për të siguruar ndarjen efikase të resurseve. Grupi Punues Qeveritar përbëhet nga përfaqësues të të gjitha ministrive dhe institucioneve përkatëse në lidhje me parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare. Prandaj, është përgjegjëse për koordinimin dhe bashkëpunimin sa i përket hartimit dhe zbatimit të strategjive të tjera të nivelit kombëtar dhe instrumenteve të ngjashme të menaxhimit të rrezikut.

Grupi Punues Qeveritar do të mbajë së paku katër dy (2) brenda një viti kalendarik. Ajo ndihmohet nga Sekretariati. Grupi Punues Qeveritar mund të angazhoj në punën e saj ekspertë të jashtëm, kur paraqitet nevoja.

8.2.4. Sekretariati

Sekretariati është përgjegjës për të ndihmuar Grupin Punues Qeveritar. Ajo do të përgatisë gjetjet dhe propozimet me shkrim lidhur me hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018. Sekretariati do të përdorë materialin e saj për Grupin Punues Qeveritar i cili do të vendosë për veprime të mëtejshme.

Sekretariati drejtohet nga një përfaqësues nga Ministria e Financave. Anëtarët e tjerë janë përfaqësues nga:

- Ministria për Integritet Evropian;
- Policia e Kosovës;
- Dogana e Kosovës;
- Administrata Tatimore e Kosovës;
- Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës;
- Zyra e Kryeministrit të Kosovës;
- Koordinatorit Kombëtarë.

Sekretariati do të mbajë së paku katër (4) takime brenda një viti kalendarik. Ajo mund të angazhojë në punën e saj ekspertë të jashtëm, kur vlerësohet të jetë e nevojshme.

8.2.5. Grupi Teknik Punues

Grupi Teknik Punues mbështet Sekretariatit në hartimin, rishikimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018. Përgjegjësia e saj është t'i ofrojë procesit mendime të ekspertëve. Për më shumë, anëtarët e Grupit Teknik Punues duhet të veprojnë si pika të kontaktuese të institucioneve që përfaqësojnë. Ata duhet t'i ofrojnë Sekretariatit informata e nevojshme për monitorim të implementimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018. Mbledhjet e Grupit Teknik Punues dhe materialet e ngjashme do të organizohen nga Sekretariati i cili do të prezantojë konkluzionet për Grupin Punues Qeveritar.

Grupi Teknik Punues kryesohet nga një përfaqësues nga Ministria e Financave. Anëtarët e tjerë janë përfaqësues nga:

- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale;
- Policia e Kosovës;
- Dogana e Kosovës;
- Administrata Tatimore të Kosovës;
- Këshilli Gjyqësorë i Kosovës;
- Banka Qendrore e Kosovës;
- Gjykata Supreme të Kosovës;
- Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit;
- Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës;
- Përfaqësues të Sekretariatit;

Grupi Punues Teknik do të mbajë takime kur vlerësohet të jetë e nevojshme nga Grupi Punues Qeveritar dhe/ose Sekretariati.

8.2.6. Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike

Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike do të sigurojë mbështetje administrative dhe funksionale për hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare 2014-2018. Ai është anëtar i Sekretariatit. Përgjegjësitë e Koordinatorit

Kombëtar për sa i përket zbatimit të Strategjisë Kombëtare 2014 - 2018 janë përcaktuar me Planin e Veprimit 2014-2018.

8.2.7. Institucionet e obliguara të sektorit publik, privat dhe të tretë

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare 2014 - 2018 është i bazuar në një partneritet në mes institucioneve të sektorit publik, privat dhe të tretë. Përgjegjësitë e tyre janë të specifikuar në Planin e Veprimit.

8.3. Hartimi, rishikimi dhe miratimi i strategjisë kombëtare dhe plani i veprimit

Përgjegjësitë për hartimin, rishikimin dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018 janë si më poshtë:

1. Ministritë dhe institucionet që janë anëtarë të Grupit Punues Qeveritar duhet të vlerësojnë mjedisin e tyre strategjik dhe operativ në lidhje me parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare. Ata duhet të marrin parasysh aktivitetet e homologëve të sektorit publik, privat dhe të tretë që janë nën mbikëqyrjen e tyre, ose që veprojnë në sferën e tyre të autoritetit dhe janë relevante në këtë kontekst;
2. Ministritë dhe institucionet të cilat janë të përfaqësuara në Grupin Punues Qeveritar duhet të raportojnë përmes përfaqësuesve të tyre në Grupin Teknik Punues në lidhje me gjetjet e tyre që kanë të bëjnë me parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare në Sekretariat të paktën katër (4) herë brenda një viti kalendarik dhe menjëherë nëse kërkojnë nevojat strategjike apo operative;
3. Sekretariati do të analizojë informacionin i cili është siguruar nga organizatat anëtare të Grupit Punues Qeveritar. Rezultatet duhet të merren parasysh gjatë hartimit ose rishikimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018. Sekretariati do të përgatisë propozime me shkrim;
4. Sekretariati do të prezantojë propozimet me shkrim për Grupin Punues Qeveritar që do të merren në konsideratë gjatë hartimit, rishikimit apo përshtatjes së Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018;
5. Grupi Punues Qeveritar me mbështetjen e Sekretariatit do të jetë përgjegjës për hartimin e propozimeve në lidhje me hartimin, rishikimin apo përshtatjen e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018;
6. Grupi Punues Qeveritar do të prezantojë propozime që lidhen me hartimin, rishikimin apo përshtatjen e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës së paku dy (2) herë brenda një viti kalendarik dhe menjëherë nëse kërkojnë nevojat strategjike ose operative; dhe
7. Qeveria e Republikës së Kosovës do të vendos për miratimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planin e Veprimit bazuar në propozimet e Grupit Punues Qeveritar 2014-2018.

8.4. Zbatimi dhe monitorimi i strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit

Përgjegjësitë që lidhen me zbatimin dhe monitorimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë Kombëtare 2014-2018 janë si më poshtë:

1. Institucionet publike të obliguara të cilat do të jenë përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare 2014-2018 janë të përcaktuara në Planin e Veprimit;

2. Autoritetet mbikëqyrëse do të jenë institucione të obliguara në lidhje me zbatimin e aktiviteteve të institucioneve të sektorit privat ose të treta të cilat janë nën mbikëqyrjen e tyre;
3. Qeveria e Republikës së Kosovës, ministritë dhe institucionet publike relevante do të sigurojnë që përgjegjësia për zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018 janë pjesë integrale e detyrave zyrtare të institucioneve publike të obliguara. Prandaj, objektivat e Strategjisë dhe veprimet e Planit të Veprimit do të integrohen në buxhetet e tyre dhe Planet e Performancës;
4. Institucionet e obliguara do të raportojnë katër (4) herë brenda një viti kalendarik përmes përfaqësuesve të tyre në Grupin Teknik Punues në lidhje me rezultatet e zbatimit të planit të veprimit të Sekretariatit. Ata do të bashkëngjisin shabllonin e monitorimit në Shtojcën 2 të raporteve të tyre. Sekretariati do të vendosë orarin e saktë për raportet;
5. Sekretariati do të hartojë katër (4) herë brenda një viti kalendarik, një raport për rezultatet e procesit të zbatimit dhe monitorimit. Ajo duhet të bashkëngjies shabllonin e monitorimit në Shtojcën 2 në draft-raportin e tij;
6. Sekretariati duhet të raportojë të paktën dy (2) herë brenda një viti kalendarik për rezultatet e procesit të zbatimit dhe monitorimit të Grupit Punues Qeveritar. Ajo duhet të bashkëngjies shabllonin e monitorimit në Shtojcën 2 në draft-raportin e tij;
7. Grupi Punues Qeveritar do të raportojë dy (2) herë brenda një viti kalendarik rezultatet e procesit të monitorimit të zbatimit për Qeverinë e Republikës së Kosovës duke përdorur raportin e hartuar nga Sekretariati. Shablloni i monitorimit në Shtojcën 2 do të bashkëngjitet raportit;
8. Qeveria e Republikës së Kosovës do të vendosë lidhur me masat e zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit bazuar në raportimin e Grupit Punues Qeveritar 2014-2018. Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin dhe masat e mundshme korrigjuese do të regjistrohen në një vendim qeveritar dhe në shabllonin e monitorimit në Shtojcën 2;
9. Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin e masave të mundshme korrigjuese duhet t'i njoftohen institucioneve të obliguara nga ana e Sekretariatit, duke u dërguar atyre vendimin me shabllonin e monitorimit në Shtojcën 2; dhe
10. Qeveria e Republikës së Kosovës do të ketë përgjegjësi të përgjithshme për zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018.